

Edukimi mediatik në Shqipëri: Udhëkryqi i vetërregullimit të pazbatuar, mungesës së një kuadri rregullator dhe roli i aktorëve të ndryshëm në një fushë jetësore për demokracinë e një vendi

Nga Roden Hoxha

Ndërkohë që ende nuk ka një përkufizim të pranuar gjerësisht mbi edukimin mediatik, ky i fundit përcaktohet zakonisht si aftësia për të aksesuar, analizuar, vlerësuar dhe krijuar përmbajtje mediatike. Qasja mund të jetë fizike ashtu si dhe aftësia për të përdorur forma të ndryshme të mediave, ndërkohë që analizimi dhe vlerësimi përfshin *"aftësinë për të kërkuar, lokalizuar dhe përzgjedhur informacionin që i përshtatet nevojave individuale të lexuesit"* dhe *"aftësinë për të vlerësuar informacionin duke u bazuar në elementeve përbërës thelbësorë si vërtetësia, ndershmëria, interesat e transmetuesit, etj."* Aftësitë e fituara përmes edukimit mediatik përfshijnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, autonominë personale dhe aftësitë shoqërore dhe komunikuese.

Të gjitha këto janë aftësi thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të mirinformuar dhe aktive në nismat sociale dhe ekonomike. Në fakt, një hulumtim i kryer nga Banka Botërore në 2012, mbi rolin e edukimit mediatik në reformat e shoqërive post komuniste, sugjeron që *"një individ që ka njohuri të thelluar mbi median, e ka më të lehtë në vendimmarrje të mirinformuar mbi çështjet / ngjarjet shoqërore dhe, në këtë mënyrë, është i pajisur më mirë për të shprehur mendimin e tij, individualisht, si dhe kolektivisht, në kontekstin shoqëror."* Për më tepër, edukimi mediatik sa vjen e më shumë shihet si një faktor kontribues për pjesëmarrjen, qytetarinë aktive, zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit gjatë jetës.

Ndërkohë që edukimi mediatik konsiderohet tashmë si thelbësor për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e garantuar të një sfoere të shëndetshme demokratike publike, shpeshherë harrohet si parakusht kur diskutohet zhvillimi i tij i mëtejshëm në shoqërinë e sotme digjitale. Duke jetuar në një epokë të re informacioni, është e rëndësishme të theksohet se edukimi mediatik përfshin të gjitha mediat, si ato tradicionale, të tilla si televizioni, radio, filmi, dhe shtypi, por edhe ato digjitale si portalet, platformat investigative, mediat sociale dhe ndërvepruese. Në baza ditore, ne jemi të rrethuar nga mesazhe të shtyra nga një ose disa medime që formojnë mendimet dhe njohuritë tona në lidhje me çështjet sociale dhe botën në të cilën jetojmë. Sot, ne jemi dëshmitarë të një progresi të shpejtë global të mjeteve të njohura të rrjeteve sociale, që promovojnë përmbajtje të gjeneruar nga përdoruesit, duke përfshirë ngarkimin e videove; blog në lidhje me interesat individuale të përdoruesve dhe çështjet aktuale; dhe angazhimi në gazetarinë qytetare, diskutime në internet dhe projekte bashkëpunuese.

Në një kohë kur teknologjitë e reja promovojnë pjesëmarrjen, pluralitetin dhe larminë e mendimeve dhe informacionit, ky inovacion gjithashtu kontribuon në një sërë sfidash të reja, të tilla si informacione të pasigurta, lajmet e rreme, keqinformimin, çështje të së drejtës së autorit dhe përdorues që përdorin platformat e reja si një mjet për përhapjen e propagandës dhe ideve keqdashëse. Si pasojë, ekziston një urgjencë për të promovuar edukimin mediatik tek qytetarët në mënyrë që këta të fundit të kthehen në konsumatorë kritikë të informacionit dhe të kontribuojnë në diskursin publik në mënyrë efektive. Në zhvillimin e aftësive të tyre mediatike, qytetarët mund të mbrojnë veten dhe të tjerët nga përmbajtja e dëmshme, e shtyrë kryesisht nga teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit. Ndërsa format e reja të edukimit në këtë fushë shfaqen si pjesë e këtij peizazhi të ri mediatik, ato nuk njihen

domosdoshmërisht dhe nuk promovohen si thelbësore për t'u zhvilluar në një shoqëri të bazuar në dije.

Forest Woody Horton në raportin e tij "Të kuptosh edukimin informativ", parashtroi një numër kategorish të edukimit thelbësor për mbijetesë në shoqërinë informative të shekullit të 21-të: aftësitë themelore të edukimit kompjuterik, edukimi mediatik, arsimi në distancë dhe e-mësimi, edukimi kulturor dhe edukimi mbi leximin e informacionit. Ndërkohë që mediat tradicionale dita ditës po kthehen në formate digjitale, dallimi midis edukimit mediatik për këto dy kategori mediash nuk është i njëjtë dhe shpeshherë krijon paqartësi në mjetet e përshtatshme për edukimin e publikut. Për shembull, edukimi mediatik shpeshherë ngatërrohet me edukimin e publikut mbi leximin e informacionit dhe nganjëherë përdoret edhe në mënyrë të njëjtë. Ndërsa edukimi informativ përqendrohet në aftësitë teknike për të zhvilluar dhe shpërndarë produktet mediatike, edukimi mediatik ka në fokus kryesor zhvillimin qytetar dhe kulturor.

Duke u kthyer në çështjen e edukimit mediatik në rajon, një raport i vitit 2019 nga Koalicioni i Përdoruesve të Informacionit dhe Mediave (CIMUSEE) i destinuar për hartëzimin dhe kuptimin më të mirë të situatës dhe zhvillimin e edukimit mediatik dhe të informacionit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni Veriore dhe Serbi ka gjetur që pavarësisht nga kornizat dhe përpjekjet e ndryshme në këtë fushë, asnjë vend në rajon nuk ka politika gjithëpërfshirëse dhe korniza institucionale për zhvillimin e edukimit mediatik, të formës sistematike dhe në shkallë të gjerë. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme në rang rajonal dhe lokal të shoqërisë civile, edukimi mediatik është lënë në harresë nga autoritetet shtetërore, si një fushë e vetëpërmbytur dhe e limituar, për shoqërinë civile, entuziastët e sektorit publik dhe organizatat ndërkombëtare. Edukimi mediatik nuk përfshihet qartë ose vazhdimisht si objektiv apo synim qendror në politikat publike ose legjislacionin e vendeve të Ballkanit. Indeksi i edukimit mediatik i 2018 i Institutit të Shoqërisë së Hapur në Sofje ka gjetur se, përtej problemeve të sipërpërmendura, vendet e Ballkanit janë më të ndjeshmit në Evropë ndaj lajmeve të rreme. Kjo për shkak të mediave të tyre të kontrolluara gjerësisht nga interesa të fshehta, niveleve të ulëta arsimore dhe niveleve të ulëta të besimit në shoqëri kundrejt medias apo aktorëve të ndryshëm në prodhimin e produkteve cilësore mediatike. Në këtë indeks, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Turqia renditen të fundit në renditjen e vendeve për edukim mediatik. Përpjekjet deri më sot kanë qenë të shumta, duke u intensifikuar më tej në vitet e fundit, por arritjet kanë qenë të limituara dhe shpeshherë të gërryera nga politikat e këqija shtetërore në këtë fushë, shtimi i tejskajshëm i mediave online, mungesa e aderimit ndaj një kodi etike të gazetarisë nga këto të fundit dhe nga aktorë kryesorë në fushë, dhe mungesës së një kuadri rregullator për këto forma të reja të përcjelljes së informacionit.

Në këtë treg të parregulluar, keqinformimi, fake news dhe abuzimi me rolin e gazetarit dhe medias ka lulëzuar në përmasa shqetësuese. Për të rregulluar këtë situatë kaotike, shoqëria civile ka ndërmarrë nisma të shumta mbi edukimin mediatik dhe vetërregullimin e profesionit, por kjo nuk ka ndaluar abuzimet nga ana e aktorëve të ndryshëm. Ndërmarrja e hapave rregulluese përmes një kuadri rregullator ligjor të panoramës online ishte hapi i natyrshëm i radhës. Qeveria shqiptare, në vitin 2018, prezantoi një nisëm ligjorë përmes të cilës do të përpiqej të rregullonte tregun mediatik online, përmes Autoritetit të Mediave Audiovizive, një nisëm pozitive në pamje të parë, por me probleme të theksuara tejkalimi të kompetencave nga ana e këtij të fundit dhe abuzime potenciale me pushtetin e dhëna nga ligji. Përballë gjithë këtyre problemeve, kjo iniciativë, e cila u paraqit dy herë votim pranë ligjvënësit, dhe herën e dytë kaloi testin e votave, u kundërshtua fortë nga aktorë

të shoqërisë civile, institucione ndërkombëtare, Presidenti i Republikës, si dhe Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit, opinioni përfundimtar i të cilit i frenoi përpjekjet e qeverisë për ti dhënë fuqi.

Në këto kushte, ku vetërregullimi si një iniciativë aplikohet vetëm nga një numër i limituar aktorësh; ku edukimi mediatik i popullatës së gjerë është tejet i limituar edhe edukimi mediatik i gazetarëve vetë është në fillimet e veta; ku kodi i etikës së gazetarëve shkelet rregullisht dhe më shpesh nga aktorët më të mëdhenj të skenës mediatike në Shqipëri; dhe ku mungon një kuadër rregullator i mirëpritur nga të gjithë aktorët e medias, cilat janë hapat e mundshëm që mund të ndërmerren?

Një hap potencial mund të jetë promovimi i rolit të Avokatit (Ombudsmanit) të Medias, ku ky i fundit shërben si vëzhgues i brendshëm i agjencive dhe redaksive të lajmeve, duke luajtur një rol kritik në forcimin e praktikave të mira dhe etike në raportim dhe media, duke monitoruar saktësinë dhe ekuilibrin në lajme. Më tej ky i fundit mund të shërbejë si një ndërmjetës mes qytetarëve dhe agjencisë së lajmeve. Ombudsmani i lajmeve trajton ankesat nga lexuesit dhe ndihmon që redaksitë e lajmeve të tregohet më e përgjegjshme dhe më etë arritshme për lexuesit. Një shembull i mirë në këtë drejtim janë redaksitë ndërkombëtare të The Guardian, BBC dhe ABC, të cilat kanë Ombudsmatët e tyre pjesë të një organizate ndërkombëtare (ONO), e cila që nga themelimi i saj në 1980, ka ndërtuar një grup aktiv të standardeve editoriale evropiane, skandinave, britanike, amerikano-jugore, indiane, australiane dhe kanadeze, dhe ankesave editoriale që trajtojnë drejtuesit e mediave.

Më tej, fiqizimi dhe shtimi i mëtejshëm i hapave të ndërmarra në fushën e edukimit mediatik përmes mobilizimit, forumeve dhe debatit publik, është një nisëm e cila në planin afatgjatë ka potencialin të korrë fryte suksesi të arritshme dhe të matshme në disa drejtime, përfshirë ndërgjegjësimin publik, presionin drejt medias vetë për produkte etike dhe cilësore, dhe autoriteteve shtetërore për ndërmarrjen e hapave të prekshme për përfshirjen e këtij subjekti në kurrikulat shkollore të përgjithshme. Përtej kontekstit arsimor, krijimi dhe promovimi i hapësirave interaktive për qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar për të diskutuar dhe debatuar lirshëm çështjet aktuale, praktikat e medias dhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve mund të shihet si një hap kyç. Ky bashkëveprim mundëson edukimin e qytetarëve; përhap vetëdijen për rolet ideale të medias; ndërton dhe mbështet sistemet e mediave të lira, pluraliste dhe të pavarura; dhe promovon një kulturë të përshtatshme për ngritjen e pyetjeve të rëndësishme për qytetarë aktivë.

Promovimi i forumeve publike për të inkurajuar dialogun midis aktorëve të ndryshëm, përfshirë autoritetet rregullatore, shoqatat, edukatorët, qytetarët dhe profesionistët e medias; inkurajimi i aktorëve të tjerë në sferën publike, të tillë si autoritetet rregullatore dhe organizatat e shoqërisë civile, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për edukimin mediatik, ligjet dhe rregulloret; përfshirja e qytetarëve në diskutime rreth kodeve të sjelljes për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të siguruar që këto të fundit të zbatohen; rritja e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile mbi edukimin mediatik dhe Inkurajimi i projekteve të përbashkëta mes qytetarëve, medias dhe autoriteteve rregulluese, mund të shihen si një fillim i mbarë në një klimë tejet të pasigurt dhe problematike për lexuesit, qytetarët, rregullatorin por dhe median vetë.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program “Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans” is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM .